Matematikë e thjeshtë: 340 njerëz të infektuar nga Kumanova ≠ gjysma e Kumanovës


Ne jemi vazhdimisht të rrethuar nga informacione të ndryshme, kështu që është e nevojshme të jemi në gjendje të merremi me fluksin e tyre të pakontrolluar. Njerëzit vërtet kanë nevojë për njohuri të reja për të qenë në gjendje të marrin pjesë në jetën shoqërore duke përdorur median dhe teknologjitë e reja informative. Shpërthimi i përhapjes së sensacionalizmit është një sfidë serioze në të gjithë botën. Pothuajse gjithmonë mbart mesazhe manipuluese. Shtrembërimii i qëllimshëm inkurajon frikën e fshehur te njerëzit.

Në këtë periudhë, lajmet në lidhje me virusin e koronës janë aktuale. Për shkak të seriozitetit të kësaj teme, është shumë e rëndësishme që informacionet e marra nga qytetarët të jenë të vërteta dhe të mos shkaktojnë panik.

Ky nuk është rasti me informacionin e publikuar në portalin www.think.mk, më saktë lajmi me titull **"Kryetari i komunës ka infektuar gjysmën e Kumanovës – Dhjetë antarë në shtabin komunal të krizave dalin POZITIV me koronavirus, ndërsa ata e çuan virusin në shtëpi te familjet e tyre"** …



Gjëja e parë dhe më e rëndësishmja që është vërejtur nga ne është gabimi i shtypit në titullin e tekstit gazetaresk, të cilin vetë gazetari nuk duhet ta lejojë. Por sidoqoftë, gabimet ndodhin. Ajo që nuk duhet të ndodhë në gazetarinë profesionale është shpërndarja e një titulli që përmban një mesazh senzacional, i cili në këtë rast bazohet në një pretendim pa prova dhe fakte të vërteta nga një burim përkatës. Përmes kësaj qasjeje, autori shkakton frikë dhe panik te banorët e Kumanovës, por edhe në të gjithë vendin. Sipas informacionit zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik, deri sot , më 20 Prill 2020, gjithsej janë infektuar 340 qytetarë nga Kumanova.



Përmbajtja e lajmit gjithashtu thotë se dhjetë anëtarë të shtabit komunal të krizave janë pozitiv me koronavirusin. Në të njëjtën kohë, theksohet se disa prej tyre tashmë kanë ndarë informacione në faqet e tyre në Facebook në lidhje me pozitivitetin e testit. Pra, lajmi përbëhen vetëm prej dy fjalive që në asnjë rast nuk konfirmojnë deklaratën e bërë më herët se kryetari i Kumanovës ka infektuar gjysmën e Kumanovës, as se anëtarët e shtabit të krizave kanë infektuar familjet e tyre.

Десет члена на општинскиот кризен штаб се позитивни на коронавирус, потврдија од кумановскиот Центар за јавно здравје.

Покрај командантот на штабот, Максим Димитриевски, позитивни се и други девет члена на штабот во кој има претставници од локални и државни институции.

Дел од нив, веќе и самите споделија на социјалните мрежи дека се позитивни на коронавирус.

Sipas kësaj, ne mund të shohim se titulli nuk është aspak i përshtatshëm për përmbajtjen dhe përfundimin e tekstit, i cili sqaron arsyen pse është shkruar: të tërheq vëmendjen dhe të marrë pikë për lexim.

Në të njëjtën kohë, ajo që ishte interesante, dhe që kemi vërejtur gjatë rishikimit të të gjithë faqes në internet www.think.mk, është se ajo nuk ka asnjë impresum, dhe inicialet I.M. qëndrojnë prapa çdo artikulli lajmesh të postuar në këtë portal. Kjo konfirmon vetëm faktin se uebfaqja nuk është një medium i vërtetë që transmeton informacion të verifikuar dhe të saktë.

Shumë lexues janë mësuar të lexojnë vetëm titullin e teksteve gazetareske. **Prandaj, kontrolloni para se të besoni!**

Autorët:

Marija Angjelkoska, 16 vjeçare

Teodora Todorovska, 16 vjeçare